



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P-151  
Prishtinë, më 30 janar 2014

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 30 DHE 31 JANAR 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Glauk Konjufca e Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ramë Vataj, Armend Zemaj, Albin Kurti, Ardian Gjini, Jeton Svirca, Petar Miletqi, Aurora Bakalli, Salih Morina dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me çështjen e mosrealizimit të së drejtës së përfituesve të pensionit për qytetarët e Kosovës në Zvicër.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Deputeti Agim Kuleta parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me masat e ndërmarra për kthimin në pronat e tyre të rreth 12000 shqiptarëve të pjesës veriore të Mitrovicës, në vitin 2000.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Afrim Kasolli parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me nënshkrimin e një kontrate ndërmjet Ministrisë që ai drejton dhe kompanisë kroate “AIKATE” nga Zagrebi, për ofrimin e shërbimeve SMS Flexy-S institucioneve arsimore të Kosovës.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Afrim Kasolli.

Deputeti Muhamet Mustafa parashtoi pyetje për ministrin Fadil Ismajli në lidhje me mosprocedimin e Projektligjit për “Trepçën” në Kuvendin e Kosovës, cilat janë orientimet e Qeverisë së Kosovës për “Trepçën” dhe çka po ndodh në Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me “Trepçën”?

Ministri Fadil Ismajli iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhamet Mustafa.

Deputeti Muhamet Mustafa parashtoi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se çfarë është ndërmarr në Ministrinë që ai drejton dhe në Institutin për Krime Lufte, lidhur me ndriçimin e helmimit të të rinjve të Kosovës, në pranverë të vitit 1990.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtoi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me atë se sa për qind e mjeteve janë shpenzuar për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugëve magjistrale Prishtinë - Mitrovicë dhe Prishtinë - Pejë.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se sa është rritur borxhi publik prej vitit 2010.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputeti Daut Haradinaj parashtoi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me punën e Komisionit qeveritar për verifikim të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetit Daut Haradinaj.

Deputeti Daut Haradinaj parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me mos respektimin e vendimeve të institucioneve të pavarura .

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Daut Haradinaj.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me shkaqet e moszbatimit të Ligjit për pagat e nëpunësve civil.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Albana Gashi parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me shkaqet e mos kompensimit të personave të verbër, konform Ligjit për persona të verbër.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

\* \* \*

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

## **Rend dite**

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës,
13. Raporti i punës së Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore,
14. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar.

\* \* \*

### **3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme**

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur me 23 janar 2014, pa asnjë vërejtje.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive**

Kryesuesi Glauk Konjufca ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Ministri Agim Çeku tha se ratifikimi i kësaj marrëveshje do të rezultonte me avancimin e bazës ligjore për FSK-në, si një forcë profesionale mobile e pajisur mirë, e zbarkueshme dhe multietnike, e autorizuar për të shërbyer brenda dhe jashtë vendit.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të Projektligjit dhe ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të

Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Diskutimi i ministrit Agim Çeku është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti deputeti Ahmet Isufi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Fatmir Xhelili – në emër të GP të PDK-së, Vjollca Krasniqi - në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ahmet Isufi - në emër të GP të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të GP të KKR-së, Rasim Demiri - në emër të GP “6+”si dhe Alma Lama, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, ndërsa miratimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes kërkon votën e së paku dy të tretave të deputetëve të Kuvendit.

Procedimi me votim do të bëhet në momentin kur të plotësohet kuorumi në Kuvend.

## **5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit**

Kryesuesi Glauk Konjufca ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

Ministri Besim Beqaj tha se ratifikimi i kësaj marrëveshje do të rezultonte me sigurimin e 23 milionë euro, e përbërë nga huaja dhe kontributi financiar, shumë e cila do t'i sigurohet Agjensionit për Sigurimin e Projektit (KOSST) për realizimin e projektit të përmirësimit të rrjetit dhe transmisionit, sipas kushteve të parapara në marrëveshje.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të projektligjit dhe ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

Diskutimi i ministrit Besim Beqaj, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij Projektligji e paraqiti deputetja, Jelena Bontiq.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të GP të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të GP të KKR-së; Jelena Bontiq, në emër të GP SLS, si dhe Alma Lama, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, ndërsa miratimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes kërkon votën e së paku dy të tretave të deputetëve të Kuvendit.

Procedimi me votim do të bëhet në momentin kur të plotësohet kuorumi në Kuvend.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës**

Kryesuesi njoftoi deputetët se Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës është propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Më pas kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, që në cilësinë e propozuesit, para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Deputeti Zenun Pajaziti në emër të Komisionit FunkSIONAL tha se Shërbimi gjeologjik i Kosovës do të funksionojë si agjenci e pavarur në kuadër të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, e përbërë nga stafi gjeoshkencor kosovar, të cilët kanë aftësi të mjaftueshme dhe kompetenca për t’i përmbushur normat në përputhshmëri me standardet evropiane.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe ftoi deputetët për miratim, në parim të këtij projektligji.

Diskutimi i deputetit Zenun Pajaziti është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ramiz Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Justina Pula-Shiroka dhe Sala Berisha-Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Ministri Fadil Ismajli tha se qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i procedurave, kushteve të përcaktimit dhe të zbatimit të masave antidamping dhe masave kundërbalancuese me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe prodhimit vendor në rastet kur dëmtohet dhe pengohet nga praktikat jolojale të tregtisë ndërkombëtare përmes importeve të dampuara ose të subvencionuara.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Shaip Muja - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ramiz Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma.

Ministri Dardan Gashi tha se hartimi i këtij projektligji konsiderohet i nevojshëm pasi që Ligji ekzistues nr. 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma nuk është në përputhshmëri me direktivën 2002/49/EC të Parlamentit Evropian.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sevdije Lama, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Xhafer Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Jeton Svirca, Myfera Shinik, Emin Gërbeshi, Muhamet Mustafa, Ganimete Musliu, Myzejene Selmani, Enis Kervan, Alma Lama, Amir Ahmeti, Daut Haradinaj, Fikrim Damka dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 38,  
Kundër -----30,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma. Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij**

Kryetari i njoftoi deputetët se Projektligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij është propozuar nga deputeti Agim Kuleta dhe grupi i deputetëve nënshkrues.

Më pas kryesuesi e ftoi deputetin Agim Kuleta që në cilësinë e propozuesit, para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Deputeti Agim Kuleta në emër të grupit të deputetëve nënshkruar tha se ky projektligj do të rregullojë kushtet e përgjithshme për përcaktimin e zonës së rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, mënyrën e financimit si dhe mekanizmat institucional për zbatimin e tij.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe ftoi deputetët për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Diskutimi i deputetit Agim Kuleta është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Rasim Demiri, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Bekim Haxhiu, Ganimete Musliu, Ali Sadriu, Time Kadrijaj, Aurora Bakalli, Donika Kadaj-Bujupi, Xhafer Tahiri, Emin Gërbeshi, Sala Berisha-Shala, Jeton Svirca, Shaip Muja, Agim Kuleta dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Sabri Hamiti e hodhi në votim Projektligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri**

Kryesuesi Sabri Hamiti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

Ministri Bajram Rexhepi tha se në këtë projektligj, si institucione për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë do të përfshihen edhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe operatorët e sigurimit në institucionet shtetërore, me

qëllim të pajisjes me armë, municion dhe pajisjes përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ahmet Isufi, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Ganimete Musliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Sala Berisha-Shala, Rexhep Selimi dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

.Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për armë.

Ministri Bajram Rexhepi tha se ky projektligj rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës të destinuar vetëm për përdorim civil.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit armë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Rexhep Selimi, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Shaip Muja, Bekim Haxhiu dhe Ramiz Lladrovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për armë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për armë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Deputetët Bekim Haxhiu, Shaip Muja dhe Ramiz Lladrovci thanë se pjesën tjetër të diskutimit do ta dorëzojnë me shkrim.

## **12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Ministri Besim Beqaj tha se çështje kryesore e trajtuar në këtë projektligj është themelimi i Inspektoratit të Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Jelena Bontiq, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Muhamet

Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Justina Pula-Shiroka dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,  
Kundër ----- 2,  
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

\* \* \*

Në vazhdim, kryetari propozoi që shqyrtimi i pikave vijuese të vazhdohet më 31 janar 2014.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit

Kryetari, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i punimeve të kësaj mbledhje plenare do të bëhet më 31 janar 2014, në orën 10:00.

\* \* \*

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 18 : 25 minuta.

\* \* \*

*E premte, më 31 janar 2014*  
*Vazhdimi i mbledhjes plenare*

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 30 janar 2014.

Në vazhdim kryesuesi procedoi me pikat, si në vijim:

*4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive*

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur me 30 janar 2014, mirëpo në mungesë të kuorunit, procedimi me votim është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Ai më tej sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 89 deputetë.

Më pas kryetari hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 87,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Miratohet Ligji nr.04/L-248 për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

2. Ligji i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.

*5. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit*

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2014, mirëpo në mungesë të kuorunit, procedimi me votim është shtyer për mbledhjen e sotme.

Ai më tej sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Ai konstatoi se të pranishëm në sallë janë 90 deputetë.

Më pas kryetari hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 89,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Miratohet Ligji nr .04/L-239 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

2. Ligji i dërgohet presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.

### **13. Raporti i punës së Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore**

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, i njoftoi deputetët se deputeti Haki Demolli, kryetar i Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit lidhur me punën e Komisionit që ai udhëheq.

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 27 janar 2014, ka kërkuar nga ky komision që të përgatisë një raport të detajuar të punës për reformën zgjedhore dhe Kuvendit t’ia paraqesë rekomandimin lidhur me këtë çështje.

Komisioni ad hoc për Reformën Zgjedhore e ka proceduar raportin përmbledhës për punën e tij.

Deputeti Haki Demolli, paraqiti para Kuvendit raportin e punës së Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore.

Ai më tej foli edhe lidhur me rekomandimet e propozuara një nga një në raportin e Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore.

Në fund ai kërkoi që i tërë materiali punues i komisionit që ai ka udhëhequr të kalojë në kompetencë të Komisionit për Legjislacion.

Diskutimi i zotit Haki Demolli është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të punës së Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar KKR, Jasmina Zhivkoviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, Halit Krasniqi, Visar Ymeri, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi, Ismet Beqiri, Lirije Kajtazi, Suzan Novoberdaliu dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas përfundimit të këtyre diskutimeve kryesuesi Sabri Hamiti ia paraqiti Kuvendit tekstin e propozim-vendimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryetari hodhi në votim tekstin e propozim-vendimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,  
Kundër----- 1,  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

### **V E N D I M**

1. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që ta përfundojë punën e Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore, në cilësinë e Komisionit Funkcional.
2. Materiali punues i Komisionit Ad Hoc për Reformën Zgjedhore i procedohet Komisionit për Legjislacion për ta hartuar Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

#### **14. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar**

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes” Vetëvendosje”, për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin parlamentar.

Ai kërkoi nga deputetët që përmes një votimi formal, me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.  
Kuvendi e miratoi propozimin e lartshënuar.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

### **V E N D I M**

1. Deputeti Faton Topalli emërohet zëvendëskryetar i parë i Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në vend të ish-deputetit Liburn Aliu.
2. Deputeti Faton Topalli emërohet anëtar i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të ish-deputetit Liburn Aliu.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

\* \* \*

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*